

radio mund të blihen; dëgjuesit dhe grupet e lutjes mund të kontaktohen dhe inkurajohen; dhe të varfërit mund të marrin aftësi trajnimi.

25. Më shumë vajza dhe gra të ndërmarrin hapa me kurajo për të përmirësuar jetën e tyre dhe të heqin dorë nga aktiviteti i hershëm seksual.

26. Gratë e guximshme që punojnë shumë për të siguruar ujë të pastër për familjet e tyre dhe komunitetet për të parandaluar sëmundjet dhe vdekjet, duke inkurajuar jetë të shëndetshme që lavdëron Zotin

27. Gratë që dëgjojnë programet “Shpresë për ty” në radio, internet, dhe CD të kuptojnë dashurinë e Zotit për to dhe të pranojnë dhuratën e tij të shpëtimit. Shumë bëjnë pyetje përmes telefonit, facebook, faqeve të internetit dhe studimeve biblike që zhvillohen në skype.

28. Bashkëshortet që nuk kanë kontroll mbi marrëdhëniet e burrave të tyre me të dashurat, prostitutat dhe gra të tjera. Përveç humbjes së dinjitetit dhe vetmisë pushtuese, ato kanë frikë se mos infektohen nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme ose nga braktisja. Shumë nuk kanë edukim ose një punë dhe s’mund të sigurojnë vazhdimisht për fëmijët e tyre.

29. Gratë dhe vajzat që janë në zonat e luftës ose në kampet e refugjatëve. Shumë janë në rrezik të urisë dhe përdhunimit. Lutuni për gratë që vizitojnë me guxim këto kampe refugjatësh dhe ndajnë dashurinë e Zotit me të tjerët.

30. Gratë dhe vajzat që të njohin identitetin e tyre në Krishtin dhe vlerën e tyre për familjet dhe shoqërinë.

31. Gratë dhe vajzat që kanë refuzuar prangat e magjisë, adhurimin e stërgjyshërve dhe praktikat e rreme fetare, dhe tani ndjekin Krishtin. Lutuni për anëtarët e familjes që të pranojnë dhuratën e shpëtimit të Zotit.

Të lutemi për gratë anë e mbarë botës

Shumë gra që dëgjojnë programin “Shpresë për ty” të Projektit Ana ose luten sipas kërkesave mujore të kalendarit jetojnë në varfëri ekstreme. Shumë prej tyre janë braktisur nga etërit e fëmijëve të tyre ose i kanë parë burrat dhe fëmijët duke vdekur për shkak të mungesës së financave. Kushte të thjeshta mjekësore, si infeksioni urinar, mund t’i marrë jetën fëmijëve nëse nuk trajtohet.

Lajmet janë të mbushura me ngjarje të dhimshme që u ndodhin grave dhe vajzave të vogla anë e mbanë botës. Shumë zgjedhin të injorojnë historitë e tmerrshme dhe të tjerë e lejojnë shkeljen e tyre të justifikuar t’i cojë ata në zemërim të pakontrolluar, dyshim dhe dëshpërim. Por, Zoti po punon! Shumë gra dhe vajza që jetojnë në situata të tmerrshme po dëgjojnë për dashurinë e Zotit për to. Ato gjithashtu po e lejojnë Krishtin të arrijë të tjerët përmes veprimeve të tyre të përditshme. Duke dëgjuar historitë e këtyre grave që kapërcejnë betejat mund të na mësojnë shumë gjëra për kuptimin e fjalëve bekim, problem, shqetësim, falenderim dhe nevojë.

Duke u lutur me dhe për motrat tona anë e mbanë botës, ne lejojmë Zotin të tregojë bekimet e tij të shumta në jetën tonë. Duke shijuar shpresë në mes të dëshpërimit, ato na tregojnë mrekulli të mahnitshme nga Perëndia. Gëzimi i tyre i vërtetë në mes të dhimbjeve është ngjites. Duke i parë ato të sakrifikojnë për të tjerët edhe kur ato vetë kanë nevoja të mëdha, zemrat tona mbushen me një siguri pushtuese që Zoti po punon!

Ejani dhe bashkohuni me ndërsa lutemi për gratë rreth e rrotull botës të përfetojnë gjërat që Perëndia ka për gjithësecilën.

Ju lutem bashkohuni në sezonin tonë 40 ditor të lutjes dhe agjërimit nga 1 Tetori – 9 nëntor.

Nëse dëshironi, mund t’i dërgoni kërkesat tuaja të lutjes në adresat:
Kutia postare 130 Tiranë, ose në: valetungjillit@yahoo.com

Të lutemi për gratë anë e mbanë botës



Tetor 2015

Qëndroni me ne në Radio 7:

Kalendari i lutjes -- cdo ditë ora 7:15/22:00

Shpresë për ty - të shtunë/ të dielë ora 8:30/ 15:30



Ju lutemi lutuni për...

1. Këmbëngulje për ato mijëra gra në qindra grupe lutje të Projektit Ana në Afrikë, Amerikat, Azi dhe Evropë që lutën bashkë përmes kërkesave të lutjes në më shumë se 85 gjuhë.

2. Drejtimin, mbrojtjen dhe bekimin e Zotit mbi punonjësit e Projektit Ana në mbarë botën që përballen me shumë sfida ndërsa arrijnë gratë që janë në nevojë të miqësisë dhe dashurisë së Perëndisë.

3. Lutuni që asgjë mos ta pengojë detyrën e përfundimit të regjistrimit dhe shpërndarjes së “Thesare të fshehura” dhe “Zërit Shërues”, radiodramave dhe programit të dishepullizimit “Portrete shprese”. “sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të botës së errësirës të kësaj epoke, kundër frymërave të mbrapshta në vendet qiellore.” (Efes. 6:12)

4. Ata, që punojnë për të shpëtuar fëmijët që përdoren si prostituta (10 milionë në mbarë botën), shumë prej të cilëve detyrohen t’u shërbejnë më shumë se 10 burrave në ditë. Lutuni që këta fëmijë të kenë një vend të sigurt për t’u shëruar, jetuar dhe për të mësuar për Zotin. “Hape gojën tënde në favor të memecit, në mbrojtje të të gjithë atyre që janë lënë pas dore. Hape gojën tënde, gjyko me drejtësi dhe mbro çështjen e të mjerit dhe të nevojtarit.” (Fjalët e Urta 31:8-9)

5. Gratë, që po mendojnë t’u japin fund shtatëzanive të tyre përmes abortit. Kërkojini Zotit t’i drejtojë ato tek një mik që do t’i ndihmojë përgjatë shtatëzanisë së tyre. Shumë janë të detyruara ta bëjnë këtë për shkak të anëtarëve të familjes ose zyrtarëve në komunitet, ndërsa të tjera gra zgjedhin të abortojnë për shkak se u kanë thënë që bebet e tyre janë vetëm një masë indesh

6. Programet “Shpresë për ty” në 69 gjuhë të vazhdojnë të inkurajojnë gratë që kanë humbur shpresën; të forcojnë gratë që ndihen të dobta; të ngrenë të rrëzuarin; të sfidojnë të shëndetshmin; të ndihmojnë ato që kanë nevojë për ndihmë; të frymëzojnë të gjithë dëgjuesit të ecin ngushtë me Zotin; dhe t’u kujtojnë besimtarëve të izoluar se ata s’janë vetëm.

7. Gratë dhe vajzat që jetojnë në kultura ku të ashtëquajturat vrasje-nderi lejohen të kryhen me pak ose aspak dënim për vrasësit. Lutuni për familjet, vajzat adoleshente të së cilave janë kthyer në një fe tjetër.

8. Gratë, që jetojnë në kultura ku i lejojnë ato të jenë të burgosura ose të qëllohen me gur për tradhëti, madje edhe kur gruaja ose vajza përdhunohet ose kur thjesht i flet një burri që s’është anëtar i familjes.

9. Zoti t’i bekojë etërit, burrat dhe vëllezërit t’i trajtojnë gratë dhe vajzat me respekt dhe dinjitet dhe t’u mësojnë edhe burrave të tjerë të bëjnë të njëjtën gjë.

10. Viktimat e skllavërisë në botën tonë sot (janë rreth 35 milion skllavër anë e mbanë botës). Lutuni për të mbijetuarit që po gjejnë shpresë dhe integritet përmes arsimimit, trajnimit profesional dhe Fjalës së Zotit.

11. Gratë, që vrasin bebet e tyre të sapolindura vajza sepse familja e burrit dëshiron fëmijë meshkuj. Lutuni që drejtuesit e komunitetit që punojnë për të ndaluar këtë praktikë kulturore të jenë të suksesshëm.

12. Vajzat e vogla që detyrohen nga anëtarët e familjes dhe praktikat kulturore për të kryer martesë të hershme. Këto nuse të vogla zakonisht lënë shkollën; shpesh janë të ekspozuara ndaj dhunës, sëmundjeve dhe shfrytëzimit; dhe ndoshta mund të humbin jetën e tyre gjatë shtatëzanisë, lindjes së fëmijëve apo komplikacioneve të tjera.

13. Gratë, që durojnë punën rraskapitëse për orë të gjata për pak para. Lutuni për gratë që përshkojnë distanca të gjata cdo ditë për të mbledhur dru zjarri dhe ujë, dhe vec kësaj për t’u kujdesur për prodhimet e tokës, për fëmijët, dhe punojnë shumë për të përgatitur ushqimin për familjen.

14. Ata që përjetojnë dhunë në familje në shtëpitë e tyre ku fjalët e dhunshme, sjellja kontrolluese, ose abuzimi fizik apo seksual nga një anëtar familje, kujdestar, ose mik i familjes i shtyn ata të jetojnë në frikë dhe poshtërim.

15. Gratë që janë të izoluar nga familjet e tyre dhe kultura, nuk lejohen të bëjnë zgjedhje për të ardhmen e tyre. Disa madje nuk lejohen që t’i flasin askujt tjetër veç burrit të tyre.

16. Mundësi për 4 miliardë komunikues verbalë në botë që s’mund ose nuk zgjedhin që të mësojnë duke lexuar, që Zoti të sigurojë mundësi që ata të dëgjojnë për dashurinë e Zotit dhe shpëtimin e Tij.

17. Vejshat, gratë e braktisura, dhe jetimët që luftojnë për të mbijetuar. “Mbroni të dobëtin dhe jetimin, sigurojini drejtësi të vuajturit dhe të varfërit. Çlironi të mjerin dhe nevojtarin; shpëtojeni nga dora e të pabesit.” (Psalmi 82:3-4).

18. Organizatat që punojnë me kurajo me drejtuesit botërorë për të siguruar drejtësi për viktimat e skllavërisë, shfrytëzimit seksual dhe forma të tjera të shtypjes së dhunshme.

19. Mamitë, që të trajnohen për t’u kujdesur siç duhet për gratë që lindin. Lutuni për gratë e krishtera që po i ndihmojnë financiarisht këto gra që vuajnë nga fistulat, shkarja e mitrës dhe shtrembërimi gjenital të kryejnë operacionin që u duhet.

20. Skuadrat e Projektit Ana që vizitojnë dhe mësojnë gratë në burgjet e Angolës, Shqipërisë, Republikës Demokratike të Kongos, Etiopisë, Ganës, Indonezisë, Bregun e Fildishtë, Kenia, Liberi, Nepal, Paraguaj, Portugali, Afrikën e Jugut, Tanzani, Tajlandë dhe vende të tjera.

21. Nënata të mësojnë fëmijët e tyre të duan Zotin, të respektojnë fqinjët, dhe të duan anëtarët e familjes. Lutuni për nënat e vetmuara që luftojnë për t’u kujdesur për fëmijët e tyre.

22. Gratë dhe vajzat që kanë mbijetuar nga abuzimi seksual të mund të marrin kujdesin e nevojshëm. Përdhunimi është një nga krimet më të pa raportuara për shkak të qëndrimit mbizotërues që sjell turp mbi familjen e viktimës. Në shumë zona nuk ka mbrojtje për viktimat, që shpesh dëmtohen nga ata që duhet t’i mbrojnë.

23. Gratë në Azinë Qendrore, Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore që marrin Fjalën e Zotit përmes programeve radiofonike ndërsa jetojnë në izolim social. Lutuni për siguri për skuadrat e “Shpresë për ty” në gjuhët Arabe, Berber-Kabyle, Farsi, Kazak, Kyrgyz, Pashto, Somali, Tajik, Turkmen dhe Uzbek.

24. Zoti të vazhdojë të sigurojë financat në mënyrë që programi “Shpresë për ty” të vazhdojë transmetimin në 69 gjuhë dhe të prodhohet në gjuhët shtesë;